



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
DREJTORIA EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI I ANKESAVE DHE MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN**

Nr. 3427 Prot.

Tiranë, më 27 . 11 .2025

NJOFTIM ME SHPALLJE

TË VENDIMIT NR. 2618/1 PROT., DATË 15.10.2025 TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, “PËR PËRFUNDIMIN PA VENDIM PËRFUNDIMTAR TË PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT TË ANKESËS SË PARAQITUR NGA SHTETASIT ZNJ. LIRETA MËZIRI DHE Z. KASTRIOT MËZIRI”

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesën e paraqitur nga znj. Lireta Mëziri dhe z. Kastriot Mëziri, me nr. 1866 prot., datë 18.06.2022, në të cilën ngrihen pretendime ndaj veprimtarisë së magjistratit P.H., me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë të Shkallës së Parë në Tiranë, në kohën kur shkelja e pretenduar ka ndodhur, dhe me vendimin nr. 2618/1 prot., datë 15.10.2025 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për përfundimin pa vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit të ankesës së paraqitur nga shtetasit znj. Lireta Mëziri dhe z. Kastriot Mëziri”, bazuar në nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative, nenin 122, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ka vendosur arkivimin e ankesës. Vendimi duhet t’i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë të Prokurorisë brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e komunikuar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, Inspektori i Lartë të Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Kamëz, sipas adresës së lënë nga ankuesit: Bulevardi “blu”, banesa nr. 3, Bathore, Kamëz;
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: www.ild.al

Shpalljet që do të afishohen, hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

